



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

Mbledhja jashtë rradhe e Këshillit Bashkiak Vau Dejës, datë 05.06.2025

Data 05.06.2025 ora 14:00.

Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.

Me këtë rend dite:

Projekt vendim për ndryshimin e Vkb nr.84 datë 23.12.2024 “Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA Përfundimtare 2025-2027 dhe numrin e punonjesve të Bashkisë Vau Dejës”.

Grupe interesi nuk ka të pranishëm, votimet do bëhen të hapura.

Mbledhja jashtë rradhe e Këshillit Bashkiak Vau Dejes me kërkesë të Kryetarit u zhvillua me datë 05.06.2025 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepija. Të pranishëm në sallë ishin 19 këshilltarë, (Ervis Shimaj, Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Rita Preçi, Ornela Lleshi, Mirela Vasija, Meliha Zyberaj, Mark Bisha, Kastriot Shkjau, Vjollca Zagani, Violetë Markolaj, Rregjinë Shelqetja, Majlinda Ndreca, Besmir Kapaj, Roberto Trushi, Albina Livadhi, Marin Dodaj, Martin Mardodaj) korum i mjaftueshëm dhe i nevojshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj -kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dites dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës. Këshilltarët shprehen dakortësi.

Z. Ervis Shimaj e hedh në votim rendin e ditës:

Miratohet me 19 vota Pro, zero vota kundër, zero vota abstenim.

Këshilltarët që votuan Pro rendin e ditës, (Ervis Shimaj, Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Rita Preçi, Ornela Lleshi, Mirela Vasija, Meliha Zyberaj, Mark Bisha, Kastriot Shkjau, Vjollca Zagani, Violetë Markolaj, Rregjinë Shelqetja, Majlinda Ndreca, Besmir Kapaj, Roberto Trushi, Albina Livadhi, Marin Dodaj, Martin Mardodaj)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:

Projekt vendim për ndryshimin e Vkb nr.84 datë 23.12.2024 “Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA Përfundimtare 2025-2027 dhe numrin e punonjesve të Bashkisë Vau Dejës”.



Z. Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj. Elsa Tanushi përgjegjëse e zyrës financë buxhetit Bashkia Vau Dejës e cila relatoi se ky projekt vendim ka për qëllim përmirësimin e Vkb nr.84 datë 23.12.2024 "Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA Përfundimtare 2025-2027 dhe numrin e punonjesve të Bashkisë Vau Dejës" dhe Shprehjes Ligjshmerisë nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025, duke plotësuar nevojat e Bashkisë Vau Dejës. Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresën nr.2174/1 datë 09.04.2025 "Njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për objektet shkollore të arsimit parauniversitar dhe programit për sportin", protokolluar nga Bashkia Vau Dejës me nr prot 799/3 datë 14.04.2025, ka vënë në dijeni Bashkinë për miratimin e financimit të projektit "Rikonstruktiv i shkollës 9-vjeçare dhe e mesme + shtesë 2 kat Bushat", dhe me Shkresën Nr prot 3196 datë 22.05.2025 "Për realizimin e projekteve me cikël financimi 2025-2026", protokolluar nga Bashkia Vau Dejës me nr prot 799/4 datë 26.05.2025, ka vijuar me transmetimin e informacionit të tjera përkatëse. Bashkia Vau Dejës është e angazhuar në bashkëfinancimin e këtij projekti në masën 15% të vlerës totale të tij, dhe vlera e bashkëfinancimit nga ana e Bashkisë me fondet e veta është për vitin 2025 në masën 4.376.857 lek, dhe për vitet 2026-2027 17.507.428 lek. Total vlerë bashkëfinancimi nga NJQV është 21.884.285 lek. Në kuadër të kësaj vlere bashkëfinancimi, është e nevojshme që keto vlera të jenë të disponueshme në programin 09120.

Pra buxheti i miratuar i vitit 2025 për bashkinë Vau Dejës, nuk pëson ndryshim fondesh por vetëm ndryshim i emërimit të investimit, e cila kërkohet edhe nga dega e thesarit Shkodër. Fondi është i parashikuar që në momentin e miratimit të buxhetit të vitit 2025.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët për pyetje apo diskutime.

Z. Marin Dodaj- këshilltarë, shprehet: Jam dakort me projekt vendimin e paraqitur sepse ky investim është në të mirë të plotësimit të kushteve në sektorin e arsimit por pyes: a është parashikuar ndërtimi i ndonjë palestere pranë kësaj shkolle?

Z. Kristian Shkreli-Kryetar Bashkie përgjigjet se, është e përfshirë në projekt edhe ndërtimi i një palestere sportive e cila do ju shërbejë nxënësve të kësaj shkolle për zhvillimin e aktiviteteve mësimore sportive, gjë e cila ju ka munguar deri tani.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z. Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 19 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.

Këshilltarët që votuan Pro piken e parë të rendit të ditës:(Ervis Shimaj, Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Rita Preçi, Ornella Lleshi, Mirela Vasija, Meliha Zyberaj, Mark Bisha, Kastriot Shkja, Vjollca Zagani, Violette Markolaj, Rregjinë Shelqetja, Majlinda Ndreca, Besmir Kapaj, Roberto Trushi, Albina Livadhi, Marin Dodaj, Martin Mardodaj)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kryetari këshillit e deklaron të mbyllur mbledhjen jashtë rradhe e datës 05.06.2025 pasi nuk kishte pyetje apo diskutime tjera.

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian CELEPIJA



Këshilltarët:

- | | |
|-----------------------|----------------------|
| 1. Enis Shiri | 16. Mark Bish |
| 2. Nardh Bosh | 17. Besmir Kopp |
| 3. Meliko Zkari | 18. Violeto, Mbrketo |
| 4. Meli Topllaku | 19. Martin Kardo |
| 5. Trumpa Fola | 20. |
| 6. Onela Lleshi | 21. |
| 7. Mejlimo Adrew Y | 22. |
| 8. Rita Peci | 23. |
| 9. Leonora Penci | 24. |
| 10. Robert Trushi | 25. |
| 11. Kastriot Shkja | 26. |
| 12. Preqime Shelqetis | 27. |
| 13. Allena Livadli | 28. |
| 14. Mirela Vasija | 29. |
| 15. Vjollë Rogoni | 30. |
| | 31. |